

VENDIM
Nr. 652, datë 22.7.2015

PËR INDEKSIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË VETERANËVE TË LUFTËS
ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacional-çlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Indeksimin në masën 15.6 për qind të shpërblimit të veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, i përcaktuar në vendimin nr. 190, datë 3.5.1995, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar”, duke arritur vlerat e mëposhtme:

- a) Shpërblimi sipas shkronjës “a”, të pikës 7, nga 3 383 lekë bëhet 3 911 lekë në muaj.
- b) Shpërblimi sipas shkronjës “b”, të pikës 7, nga 2 709 lekë bëhet 3 132 lekë në muaj.
- c) Shpërblimi sipas shkronjës “c”, të pikës 7, nga 2 255 lekë bëhet 2 607 lekë në muaj.
- ç) Shpërblimi sipas shkronjës “e”, të pikës 7, nga 676 lekë bëhet 781 lekë në muaj.
- d) Shpërblimi sipas pikës 8/1 (për kohën e vuajtjes në burg mbi 6 muaj), nga 1 127 lekë bëhet 1 303 lekë në muaj.

dh) Shpërblimi sipas pikës 8/2 (për kohën e vuajtjes në burg nga 1 deri në 6 muaj), nga 678 lekë bëhet 784 lekë në muaj.

e) Shpërblimi sipas shkronjës “a”, të pikës 9, nga 3 383 lekë bëhet 3 911 lekë në muaj.

ë) Shpërblimi sipas shkronjës “b”, të pikës 9, nga 2 255 lekë bëhet 2 607 lekë në muaj.

f) Shpërblimi sipas pikës 11 nga 1 127 lekë bëhet 1 303 lekë në muaj.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përllogariten në shumën 16 600 mijë lekë dhe përballohen nga fondi i kontingjencës, të parashikuara në buxhetin e shtetit për vitin 2015.

3. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për të nxjerrë udhëzimet përkatëse teknike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.8.2015.

KRYEMINISTRI
Edi Rama